



KOMUNA E KLINËS
KUVENDI I KOMUNËS
01. Nr. 06-3987/15
KLINË, 29.5.2015

**EKSTRAKT I PROCESVERBALIT
I VAZHDIMIT TË SEANCËS SË IV-të TË DATËS 24.4.2015, E MBAJTUR MË
29.5.2015, NË ORËN 10:00, NË SALLËN E KK**

Në seancë prezantuan: Kryetari i Komunës, Sokol Bashota, kryesuesi i Kuvendit, dr Haxhi Ibishi, nënkryetari i Komunës, Enver Berisha, anëtarët e KK, drejtorët e ekzekutivit, OSBE, Zyra ligjore, Zyra e auditimit, Policia e Kosovës, komandanti Rexhë Berisha, drejtori i QKMF-së, OJQ-të, mediet etj.

Seancën e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, dr. Haxhi Ibishi, i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe ju dëshiroj mirëseardhje në këtë seancë të rregullt të KK-së. “

Haxhi Ibishi, theksoi se kjo seancë është vazhdimësi e seancës së kaluar e mbajtur më 24.4.2015, e cila u ndërpre pasi që opozita lëshoi punimet e seancës. “Pushteti komunal rreth çështjes së kërkesës së tyre rreth çështjes së Fabrikës së ujit të pijshëm i ka përmbushur kërkesat e parashtruara, prandaj me ato pika të rendit të ditës po procedojmë në këtë séance”.

Pika e tretë e renditë të ditës: Shqyrtimi i Raportit financiar të shpenzimeve për periudhën janar mars 2015.

Ramiz Rrusta, drejtor i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim raportoi në mënyrë kronologjike rreth Raportit financiar për periudhën janar – mars 2015.

Arben Limani, foli rreth pakënaqësive dhe shqetësimeve që ka GP i LDK-së rreth trendëve të shpenzimeve financiare të ekzekutivit për këtë periudhë tremujore. Anëtari Limani theksoi se ne si Grup parlamentar i LDK-së ne e kemi analizuar raportin dhe kemi vërejtjet tona të këtyre shpenzimeve. “Ka shpenzime në vazhdimësi të udhëtimet brenda vendit, të karburantet, nuk di a janë bashkë apo të ndara, shpenzimet e “Vala 900”, drekat zyrtare etj.,” shtoi anëtari Limani.

Avni Gashi, shtroi pyetjen se rritja e shpenzimeve për paga dhe mëditje për gati 25 për qind, a ka të bëjë me rritjen e pagave prej 25 për qind, apo rritjen e shpenzimeve për mëditje.

“Për fat të mirë, pohoi anëtari Gashi, kësaj radhe nuk kemi shpenzime me vendime të gjykatës, gjë që është punë e mirë”.

Tunë Dedaj, ngriti çështjen e mospagesës së komiteteve dhe të komisioneve të formuara nga Kuvendi i Komunës.

Prend Buzhala, theksoi se po më intereson një shifër që po figuron këtu, gjegjësisht po shoh një minus prej 56 për qind, pse është kjo pengesë. “Pse ka ngecje në tatimin në pronë?”- shtroi pyetjen prof. Buzhala.

Ramiz Rrusta, drejtor i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe zhvillim në mënyrë kronologjike iu përgjigj anëtarëve të cilët ngrehen çështje të caktuara rreth raportit financiar për këtë periudhë kohore janar – mars 2015.

Tunë Dedaj, tha se te shpenzimet e bartjes së nxënësve, DKA ka marrë vendim për bartjen e nxënësve të komunitetit RAE, është një ndarje dhe diskriminim ndaj nxënësve të komunitetit shqiptar dhe kjo nuk i kontribuon integritit të tyre, përkundrazi, prandaj, unë edhe e kundërshtoj këtë çështje.

Avni Gashi, theksoi se realisht vendimi që është marrë për bartjen e këtyre nxënësve të këtij komunitetit ka krijuar kundërefekt.

Prend Buzhala, tha se a është pasojë e qeverisjes së keqe apo të mirë të qeverisë komunale? “Kjo rritje e pagave po bëhet me qëllime politike”, shtoi prof. Buzhala.

Hajdin Morina, sqaroi çështjen e ngritur rreth bartjes së nxënësve të komunitetit RAE.

Tunë Dedaj, tha se po bëhet një padrejtësi ndaj nxënësve të tjerë, prandaj po e ripërsëris, se ky nuk është integrim në shoqërinë tonë.

Vlora Tafilaj, tha se dëshiroj të ngreh si shqyrtim çështjen e pagave dhe të mëditjeve. “Ne si kuvend kemi marrë vendim që të paguhen 7 komitete, në mesin e tyre edhe Komiteti për shërbime publike, mirëpo nuk jemi paguar. Kërkoj që të shfuqizohet ai vendim i këtij kuvendi ndërsa nuk po zbatohet”, shtoi anëtarja Tafilaj.

Qamile Qitaku, tha se si anëtare e atij komiteti e kemi përkrahur këtë vendim të DKA-së për bartjen e këtyre nxënësve. “Unë mendoj, shtoi anëtarja Qitaku, se ky veprim i këtij institucioni tonë është një diskriminim pozitiv. E them këtë, sepse përpjekjet tona janë që të punojmë sa më shumë në flakjen e analfabetizmit tek kjo kategori e shoqërisë sonë. Prandaj, duke i bartur këta nxënës në i shërbejmë zhdukjes së analfabetizmit, që fatkeqësisht akoma është prezent në shoqërinë tonë”, pohoi anëtarja Qitaku.

Sokol Bashota, fillimisht uroj rikonstruktivimin e përbërjes së Kuvendit, po ashtu me këtë rast kryetari Bashota njëherësh uroj edhe znj. Shukrije Shala, për aderimin e saj në GP të PDK-së.

“Shkarazi u potencuan pagesat për komitete dhe komisione. Kemi Komisionin për zgjedhjen e kryetarëve të fshatrave, angazhimit i tyre shtesë duhet të kompensohet me të gjitha format dhe mundësitë, prandaj ata duhet të fillojnë punën në terren. Jam në dakord në uljen e shpenzimeve të tjera. Duhet të gjenden forma që të kompensohen komitetet dhe komisionet”, theksoi kryetari Bashota.

Ramush Agushi, theksoi se kërkoj ndjesë për vonesën. “Për pikën, Të ndryshme kisha si propozim që të përfshihet kjo që potencoi kryetari. Kisha kërkuar që të na kompensohet dalja në terren, përndryshe nuk kemi për të pasur sukses në këtë drejtim”, pohoi anëtari Agushi.

Haxhi Ibishi, theksoi se kryetari foli për të gjitha komitetet dhe komisionet që duhet kompensuar.

Ndue Shabanaj, theksoi se desha për ta shprehur një shqetësim timin lidhur me uljen e tatimit në pronë. “Klina ka pasur një traditë të mirë në përgjigjen e obligimeve të tatimit në pronë. Jemi dalluar përherë sepse kemi pasur shkallë të mirë të pagesës. Mendoj që në këtë rënie është reflektuar vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, vendim, i cili krijoi konfuzitet”, shtoi profesor Shabanaj, i cili në vazhdim theksoi se sa i përket çështjes tjetër që u debatua këtu, nëse në njërin anë lejojmë të aplikohet “diskriminim pozitiv”, atëherë duhet të kuptojmë se në anën tjetër lejojmë “diskriminim negative”. Konkretisht: nëse ndaj një komuniteti pakicë zbatojmë “diskriminim pozitiv”, atëherë ndaj shumicës po e realizojmë “diskriminim negative”. Prandaj, unë jam kundër çdo diskriminimi”, konstatoi profesor Shabanaj.

Rasim Millaku, tha se u potencuan gabimisht komisionet, nuk janë komisione por komitete, janë komitete të formuara nga Asambleja komunale. Nga kjo asamble janë formuar 2 komitete obligative dhe pesë të tjera konsultative. Ligji thotë që këto komitete duhet të kompensohen. Pagesat për kompensimin e këtyre komiteteve i kemi planifikuar në buxhetin. Nëse flasim për vitin 2015 në kompensimin për këto komitete e kemi aprovuar dhe është marrë një herë vendim, ndërsa planifikimi i buxhetit për vitin 2016 bëhet në shtator, pra për vitin që vjen pas, atëherë vendosim edhe rreth kësaj çështjeje”, theksoi anëtari Millaku.

Fadil Gashi, tha se ligji hedh poshtë çdo udhëzim. “Vetë fakti se ligji ka paraparë për t’u paguar këto komitete doemos duhet paguar. Pagesën e ka planifikuar ligji. Nuk shkelet asnjë procedurë nëse paguhen këto komitete”, theksoi anëtari Gashi.

Kryesuesi vuri në miratim Raportin financiar të shpenzimeve për periudhën janar - mars 2015.

Kryesuesi Ibishi, sqaroi çështjen e dy procesverbaleve të seancave të kaluara.

Vuri në miratim procesverbalet e seancave të kaluara.

Procesverbalet u miratuan me vota unanime.

Me 26 vota për, i kundër u miratuar Raporti financiar të shpenzimeve për periudhën janar - mars 2015.

Pika e katërt: Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të kryetarit për vënien në diskutim publik të dy rregulloreve:

- a) Projekt-rregulloren për subvencione dhe transfere,
- b) Projekt-rregulloren për simbolet, ndarjen e titujve të nderit dhe shpërblimet tjera.

Haxhi Ibishi, tha se këto projekt-rregullore i kemi debatuar edhe në KPF dhe i kemi sjellë në Kuvend për shqyrtim dhe për vënien e tyre në diskutim publik. Hapi debatin rreth projekt-rregulloreve.

Avni Gashi, tha se projekt-rregullorja për subvencione dhe transfere i ka munguar Komunës së Klinës. “Në KPF kemi rekomanduar për t’i përcjellë në Asamblenë komunale, por jo edhe debatuar, r theksoi anëtari Gashi, i cili në vijim theksoi se qytetarët e Komunës së Klinës janë tepër të interesuar për këtë rregullore. Në vazhdim anëtari Gashi citoi edhe nenin 5 të kësaj projekt-rregulloreje. Ai shtoi se kjo projekt-rregullore ndryshon në shumë aspekte nga projekt-rregulloret e komunave të tjera. “Kjo projekt-rregullore nuk i përcakton kriteret rreth subvencioneve. Te vetësubvencionohen edhe rastet emergjente. Realisht Rregullorja nuk është në përputhje të interesave të qytetarëve. Le ta kenë një portë qytetarët ku do të kenë mundësi të drejtohen. Projekt-rregullorja nuk i plotëson kriteret për të dalë në debat me publikun pa u plotësuar”, theksoi anëtari Gashi, ” nënvizoi anëtari Gashi.

Sokol Bashota, theksoi se është mirë që çdo asamblist i ri le t’i shikojë vendimet paraprake të Asamblesë komunale. Rreth këtyre çështjeve është debatuar edhe më herët. “Kërkesat e qytetarëve dhe të tjerëve u janë drejtuar drejtorive përkatëse përmes meje dhe prapë u janë rikthyer drejtorive. Secili subvencion është përcjellë me vendim të Zyrës ligjore. Kjo rregullore është me kërkesë të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe në harmoni me Qeverinë. Për mua është më mirë sepse heq shumë dilema, një rregullore e tillë i kanalizon shumë më mirë këto ndarje. Janë të ndara limitet, nuk mund të tejkalohen dhe nuk kemi mundësi për t’i ndryshuar. Këto subvencione ndahen sipas nevojave të qytetarëve dhe të tjerëve. Janë respektuar këto limite, prandaj i shfrytëzojmë këto subvencione për nevoja të caktuara. Jemi shoqëri që jemi duke bërë përpjekje për të ndërtuar ligje. Me ligjet që do të vinë këto kjo rregullore është për të mos e ngarkuar buxhetin”, theksoi kryetari Bashota.

Avni Gashi, tha se kam bërë përpjekje për ta krahasuar me rregulloret e komunave të tjera. “Në këtë projekt-rregullore nuk kemi kriteret të caktuara”, shtoi ai.

Haxhi Ibishi, tha se diskutimet tuaja do t'u shërbejnë edhe seancave të tjera kur edhe do të debatohet rreth kësaj projekt-rregulloreje. “Kjo është projekt-rregullore, jemi në fazën e parë, të procedojmë për ta përcjellë në diskutimin publik”, shtoi Kryesuesi.

Vuri në miratim propozimin që Projekt-rregullorja për subvencione dhe transfer të përcjellët në debatin me publikun.

Me 26 vota për, 1 kundër, u miratua propozimi.

- c) Kryesuesi foli rreth projekt-rregullores nën b) Projekt-rregullores për simbolet, ndarjen e titujve të nderit dhe shpërblimet tjera.

Kryesuesi vuri në miratim Projekt-rregulloren për simbolet, ndarjen e titujve të nderit dhe shpërblimet tjera për vënie në diskutim publik

Me 26 vota për 1 abstenim u miratua propozimi që projekt-rregullorja të përcjellët për diskutim publik.

Pika e pestë: Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për plotësimin e vendit vakant me anëtar të ri nga subjekti politik i AAK-së në vend të Agron Bacajt, në Komisionin për vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale.

Kryesuesi kërkoi nga GP i AAK-së që të propozojë anëtarin për zëvendësim të z. Agron Bacaj në komisionin për vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale.

Tunë Dedaj, propozoi anëtarin nga radhët e AAK-së, z. Lorenc Marleku. Kryesuesi vuri në miratim propozimin.

Me vota unanime u miratua propozimi që anëtari nga radhët e AAK-së, z. Lorenc Marleku të përfaqësoj subjektin politik të AAK-së në Komisionin për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale.

Pika e gjashtë: Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimit më një anëtar të rinj komuniteti shkallë në Komitetin për komunitete në vend të Gani Vrankaj.

Kryesuesi sqaroi që nga komiteti për komunitete ka ardhur propozimi për znj. Mire Ramaj, që të përfaqësojë në Komitetin për komunitete.

Vuri në miratim propozimin.

Propozimi u miratua unanimisht.

Pika e shtatë: Raportimi

- I drejtorit për Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale dhe
- I drejtorit të QKMF-së në Klinë.

Haxhi Ibishi, foli rreth çështjes në rend të ditës. Fjalën ia dha z. Bedri Gashi, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Bedri Gashi, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në mënyrë kronologjike raportoi rreth gjendjes së shëndetësisë në Komunën e Klinës.

Haxhi Ibishi, falënderoi drejtorin Gashi për prezantimin e tij. Në vijim fjalën ia dha dr. Ali Ahmetxhekaj, drejtor i QKMF-së në Klinë.

Dr. Ali Ahmetxhekaj, drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Klinë, raportoi në mënyrë kronologjike rreth gjendjes në QKMF në Klinë.

Avni Gashi, theksoi se të jemi më konkretë. “Kemi pasur problem me procesverbalet, teknika nuk ka qenë funksionale. Asamblistët i kanë paraqitur problemet. QKMF në Klinë ka shumë probleme. Kërkesa për të raportuar është nga ekzekutivi. Shiheni procesverbalet kur janë aprovuar”, theksoi anëtari Gashi.

Tunë Dedaj, tha se gjendja është shumë e keqe në shëndetësi. “Fajin e kanë të gjitha qeveritë, edhe Kuvendi që nuk sjellë një vendim. Kam kërkuar nga kryetari Bashota që të ndihmohet QKMF, që të blihen barnat esenciale”, shtoi ai.

Fadil Gashi, tha se nuk po di kujt po i adresohet drejtori i shëndetësisë me atë proces. “Nëse diçka ka rrjedhur duhet përmirësuar. Të mos i adresohet asamblesë komunale me një vertikale as horizontale. Veç me sy çfarë sheh mjafton. Pastërtinë, a është për ta mbajtur, mund të mbahet. Ne çdo ditë ballafaqohemi me sëmurje. Pa hyrë në analizë për mos funksionalizimin e laboratorit. Pse po funksionojnë ata privatë? Njerëzit që punojnë i kanë gjitha barnat në barnatoret tjera. Në shëndetësi gjendjen e kemi të njëjtë në gjithë Kosovën. Duhet shfrytëzuar gjithë angazhimin tonë të përbashkët qysh për t’i sanuar këto defekte, krejt bashkë. Të gjithë e kemi vullnetin që qytetarëve tanë për t’iu kryer shërbime sa më të mira. Ta përmirësojmë gjendjen bashkë. Drejtori tha se për 24 orë kryhen shërbimet shëndetësore, kështu edhe ju obligon ligji. Mund të bëhen edhe 50 orë port ë mos punohet. Keni për obligim për të punuar. Asgjë e keqe nuk është pse po debatojmë, se njëherësh është edhe në interesat e qytetarëve”, nënvizoi anëtari Gashi.

Haxhi Ibishi, tha se Kryetari ka kërkuar që të shqyrtohet gjendja në shëndetësi dhe është një qasje shumë e mirë. “Këtij Kuvendi i propozoj për një strategji, kjo strategji të hartohet nga një komision profesional. Duhet shqyrtuar çështjen e decentralizimit financiar. Ky decentralizim financiar të bëhet në QKMF. Mjekësinë familjare ta kthejmë në politikën kadrovike. Nuk i takon Klinës disa lëmi të specializuara, si psikiatër, apo edhe ndonjë tjetër, i takojnë lëmitë e caktuara. Ky debat dhe të tjerët rreth shëndetësisë në Klinë e forcojnë menaxhmentin në QKMF dhe shëndetësi përgjithësisht. Kemi vendosur disa parime. Shëndetësia ta ketë një strategji primare dhe sekondare. Klina me kuadrin që ka, është potencial dukagjinas dhe të Kosovës,” shtoi ndër të tjera dr. Ibishi.

Skënder Merturi, tha se po me duket se për dy gjera po darkodohemi: gjendja në shëndetësinë klinase nuk është e mirë dhe 2: jemi të interesuar që këtë gjendje ta ndryshojmë për mirë. “Për strategjinë kemi vullnetin të ndihmojmë. Edhe një shqetësim tjetër që duhet të brengos shoqërinë tonë, mjekët, kuadro të profesionalizuar po na ikin jashtë. Pyes: disa rekomandime që i kemi bërë dhe nuk na kanë ardhur, pse?” - shtoi anëtari Merturi.

Pas prezantimit të sërë defektesh që janë prezent në shëndetësinë e Klinës, anëtari Merturi kërkoj nga kryetari i Komunës, z. Sokol Bashota, që drejtorët, z. Bedri Gashi, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe dr. Ali Ahmetxhaj, drejtor i QKMF-së në Klinë, t'i shkarkojë nga pozitat ekzistuese.

Prend Buzhala, tha se sistemi shëndetësor është keq. “Tri çështje desha t'i ngreh si shqetësim: Sipas drejtorit i cili tha se 29 për qind janë paguar dhe drejtori e vlerësoi së nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë po bëhet një diskriminim në këtë aspekt kur është në pyetje Klina, a ka kush përgjegjësi për këtë diskriminim? E dyta, lidhur me ndërrimet e orareve në QKMF, nuk di deri në sa ora punojnë mjekët, mirëpo është të dimë saktë, sepse njerëzit sëmurën edhe pasdite. U potencuan tri qendra të mjekësisë familjare, a ka mundësi të dimë cila është gjendja në ato qendra të mjekësisë familjare? Është mirë që ky rrjet i këtyre qendrave të shtrohet dhe të ketë punësime të kuadrove të rinj. Para luftës kemi pasur edhe ambulance, edhe barnatore. Edhe shoqata humanitare “Nënë Tereza” ka krye shumë shërbime në këtë fushë. Dëgjoj që nga ky kuadër po ka edhe burgosje, nuk e di në Klinë a ka apo jo. Kjo është një ndjenje e keqe. Ta funksionalizojmë “Betimin e Hipokratit”, shtoi ndër të tjera prof. Buzhala.

Rasim Millaku, ngrehu shqetësimin e gjendjes së QMF në Ujëmir. “Do të ndalem në QMF nga vij unë, në Ujëmir. Gjendja në këtë QMF është tepër e rëndë, nuk kemi mjek kurrë, nuk kemi asnjë minutë mjekë, patëm rastin ta kemi një mjek të mirë, mirëpo na e tërhoqën në Klinë. Do të kishte qenë me rëndësi që strategjia të aplikohet. Edhe kushtet tjera në këtë QMF janë tepër të rënda. Kjo QMF gjithëherë ka pasur mjekun, ndërsa tash nuk ka. Përgjegjësia i bie qeverisë komunale, menaxhmentit, përkatësisht drejtorit”, pohoi anëtari Millaku dhe kërkoj që kjo QMF të ketë mjekun e përhershëm.

Filloreta Berisha, tha se nuk jemi këtu për të kritikuar, por për të ndihmuar. “Duhet për t’u mburrur me potencialin e kuadrit mjekësor që ka Klina. Sa i përket listës esenciale prej 29 për qind, është pak. Klina duhet bërë planifikimin. Duhet për ta gjetur një defekt, defekti është te planifikimi. Klina, mirë që ka konsulentët, këtë problem e kanë edhe QKMF-të tjera. Edhe Prishtina ka pediatriinë për 24 orë. Ka edhe qendra të tjera që i kanë këto. Laboratori nuk punon, biokimia nuk funksionon. Jemi keq si Klinë me laboratorin. Emergjencia është në gjendje tepër të rëndë, madje një shilingë duhet gjendur aty. Pastërtia është në nivelin më të ulët, bile kjo do të mund të mbahej. Shërbimet nuk kryhen. Monitori nuk funksionon, duhet për ta gjetur mënyrën se si duhet bërë atë punë. Rëntgeni nuk është funksional, gjë që nuk kisha dëshiruar të ndodhë”, pohoi dr. Berisha, e cila në vijim i lexoi rekomandimet e Komitetit për shëndetësi. “Drejtori ka premtuar për ndryshim pozitiv të gjendjes, mirëpo nuk po ndodhin këto ndryshime pozitive. Shkelje eventuale ka plot”, u shpreh dr. Berisha.

Voletë Zefi, theksoi se meqë jam anëtare e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, desha të diskutoj rreth rekomandimeve që ne si Komitet i kemi diskutuar në takimet mujore që i kemi. “Meqë, doktoresha Filloreta veç i përmendi këto rekomandime, atëherë unë nuk po përsëritëm veç po dëshiroj të komentoj në pikat që do t’i cekim më poshtë. Nëse ju nuk mund të bëni ndryshime të mëdha në listën esenciale të barnave, rinovimin e emergjencës, apo sigurimin e laboratorëve, pasi që implikohen shuma të larta buxhetore, atëherë a mund të filloni të bëni ndryshime më të vogla, por që janë esenciale për shëndetin e pacientit, si p.sh.: A mund t’i detyroni punëtorët shëndetësorë që të respektojnë vendin e punës ashtu siç është i paraparë, nga ora 7:00 deri në orën 15:00. Apo, a mund të bëni të mundur që punëtori shëndetësor të mos i thotë pacientit në orën 12 të natës "zonjë pse keni ardhur në këtë orë të vonë!!!" A thua duhet treguar pacientëve se kur është orari që ata të sëmurën? Fatkeqësisht këto po na ndodhin çdo ditë, qoftë familjarëve tanë apo edhe të tjerëve. Pa filluar me këto ndryshime të vogla nuk do të mund t’i bëni ato të mëdhatë që i përmendem më lartë”, nënvizoi anëtarja Zefi.

Enver Gashi, tha se kam dy pyetje: Pse certifikatat mjekësore për patentë-shofer nuk mund të nxjerrën në QKMF dhe pse nuk respektohet orari i punës?- shtroi pyetjet anëtarja Gashi

Qamile Qitaku, tha se po e ndjej për obligim që të inkuadrohem në debat dhe se konsideroj se çdo debat shërben për të mirë. “Unë kisha propozuar që të bëhet një mbledhje me ekspertët shëndetësorë dhe të hartohet një strategji. E dimë që ka mangësi në shëndetësinë, mirëpo duhet pranuar se ka edhe të arritura. Ne ju bëjmë shërbime shëndetësore qytetarëve tanë këtu në Klinë dhe se qytetarët tanë nuk kanë nevojë për të shkuar më larg. Menaxhimi ekskluzivisht është në çdo nivel, mirëpo në shumë aspekte jemi të varur nga niveli qendror. Lista esenciale që u potencua këtu, mirëpo duhet ditur faktin se ne nuk kemi implikime rreth kësaj çështjeje. As kjo shifër prej 29 për qind nuk realizohet. Ne nuk kemi qasje në atë listë esenciale. Na kanë ardhur barna që fare nuk i kemi porositur dhe se nuk janë nevojitur. Kjo është gjendja e listës esenciale. Ne ose duhet pranuar, apo jo, ne nuk kemi asnjë ndikim. Kemi një kompani rreth pastërtisë, nuk kemi problem rreth pastërtisë”. nënvizoi ndër të tjera anëtarja Qitaku dhe vazhdoi: “U çmua puna, punohet shumë, kryhen mbi 180 mijë shërbime shëndetësore. Më vjen mirë që po shihet

një vullnet për të diskutuar dhe ekspertë shëndetësorë dhe për të hartuar strategjinë”, konstatoi anëtarja Qitaku.

Ramush Agushi, tha se debate i shërben qytetarëve dhe gjithë të tjerëve. “Unë me kuptimin e plotë të fjalës e konstatoi se shërbimet mjekësore janë të kënaqshme, ndërkaq ai emergjent është nën çdo nivel. Kam përjetuar vetë një përvojë të keqe në shërbimin emergjent. Kisha kërkuar që emergjencën ta ndihmojmë në mënyrë që të funksionojë si duhet”, tha anëtari Agushi.

Elvira Sejdijaj, shtroi pyetjen se sa janë të besueshme analizat në shërbimin e QKMF-së dhe pse qytetarët udhëzohen që analizat t’i bëjnë nëpër laboratorët privatë?

Halil Desku, theksoi se drejtori Gashi me ekspozueun e vet hodhi dritë mbi shumë të arritura të shëndetësisë në Klinikë, po ashtu edhe ndau vijat e përgjegjësisë. “Drejtori Gashi tregoi se çfarë është lista esenciale dhe tregoi për shëndetësinë sit a vejë në binarë”, u shpreh anëtari Desku, i cili duke folur rreth raportimit të drejtorit të QKMF-së, ai tha se nga drejtori u entuziazmove për shërbimet e mira dhe efikase që kryhen në këtë institucion tonin shëndetësor. “Megjithatë, shtoi anëtari Desku, çështjet nuk janë tërësisht për t’u lavdëruar. Pra ka ankesa të mëdha, por edhe të arritura. Thuhet që janë kryer 1800 mijë shërbime shëndetësore, kjo shifër nuk është pak, ose te Reparti i gjenokologjisë u tha se janë kryer shërbimet për 100 lindje, që do të thotë kjo shifër nuk është e vogël, mirëpo ky repart të menaxhohet më mirë. Ndalemi te shërbimi emergjentë që që nuk jam i kënaqur, nuk themi se nuk punohet. Shërbimi emergjent duhet ta ketë një ekip profesional dhe gjithëherë të jetë aktiv dhe kurdo dhe kudo t’u përgjigjet qytetarëve. Kemi nevojë për të na ardhur ky shërbim më afër qytetarëve. Jam që të funksionalizohen edhe më tepër këto shërbime në të mirë të të gjithë qytetarëve. Ta krijojmë një ambient shumë më të shëndetshëm në shëndetësinë tonë”, konstatoi profesor Desku.

Pjetër Coli, foli për gjendjen e shëndetësisë (së mjerueshme) në të kaluarën dhe për shëndetësinë shëndetësinë e sotme. “Ndjej kënaqësi të madhe me këtë potencial të mjekëve shëndetësorë. Mjekësia në Klinikë dhe në Kosovë ballafaqohet në dy mënyra: të problemeve që janë subjektive që kemi mundësi t’i evitojmë. Edhe anët objektive të cilat nuk mund t’i eliminojmë. U potencuan shumë gjera të vlefshme. Ka mundësi që me një angazhim të gjithëmbarshëm në shëndetësi shumë gjera për t’i përmirësuar. Debati është tepër i rëndësishëm dhe shumë i frytshëm. Ma merr mendja që duhet për tan a shërbyer për të mirë edhe për lëmenjtë tjerë”, tha anëtari Coli.

Haxhi Ibishi, tha se decentralizimi financiar është esencial për t’u vënë shëndetësia në binarë. “Angazhimi ynë duhet të jetë në drejtim të përpjekjeve për ta ndryshuar ligji”.

Shukrije Shala, theksoi se ju e dini gjendjen shëndetësore të djalit tim. “Unë jam e detyruar që që ta dërgoj privat, sepse në QKMF nuk guxoj, sepse aty shërbimet janë të një niveli tepër të ulët.

Sokol Bashota, theksoi se këtë debat e kam sjellë në këtë asamble komunale si rezultat që të gjitha grupet parlamentare të Kuvendit të njoftohen me gjendjen e mjerueshme në shëndetësi. “Kam pritur që të ndihmohet më shumë me propozime konkrete, mirëpo këtu nuk ndodhën propozimet konkrete. Pavarësisht që po e konstatojmë disa herë, gjendja nuk është ajo që ne e dëshirojmë. Qysh duhet qitur kufijtë, a duhet të lëvizim në kufijtë e avancimit, apo të qëndrojmë në pozitat e gjendjes aktuale. Nëse thuhet se 600 shërbime kryhen në atë hapësirë vetë ky fakt tregon se çfarë bëhet aty. Në funksion të saj duhet të jemi të gjithë. Kur flasim për keqpërdorime të flasim me emër dhe mbiemër. Nëse themi që ka mjek që barnat i çojnë në barnatoret e tyre private, normalisht se kisha dëshiruar për të ditur cilët mund të jenë dhe do të kisha ndër marrë masat. Duhet ndërmarrë hapa emergjent, sepse kemi të bëjmë me pacientët. Këtu defektet duhet ngritur dhe hulumtuar. Me 40 mijë euro nuk mund të ndryshojmë aq shumë gjendjen. Këtu të fokusohemi në seriozitetin më të madh. Të respektohet orari, menaxhmenti të mbikëqyr stafin, le ta përcjell punën dhe angazhimin e personelit. Me qëllim të avancimit të ofrimit sa më afër dhe efikas të shërbimeve shëndetësore në kuadër të CARITAS-it kemi punësuar edhe dhjetë mjekë. T’i shikojmë edhe mundësitë të tjera që shëndetësinë në komunën tonë ta vejmë në binarë të shëndoshë. Parashtruesi i kërkesës nga radhët e VV për largimin nga postet e drejtorëve, kërkesa e tij nuk mund të realizohet sepse ai nuk e ka nivelin intelektual për ta parashtruar atë kërkesë”, shtoi kryetari Bashota.

Bedri Gashi, dha sqarime shtesë rreth çështjeve të ngritura nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Tunë Dedaj, foli rreth çështjes tematike. “Zotëri drejtor i QKMF-së, keni thënë se nëse Komuna i jep 40 mijë euro do të sigurohej materiali për emergjencë. Sot nuk po deklaroheni këtu. A mund të sigurosh me 40 mijë euro materialin për emergjencë?”- pyeti drejtorin anëtari Dedaj.

Skënder Merturi, tha se me gjithë bashkëndjenjen me Shukrijen të cilës ia dimë fare mirë gjendjen dhe na vjen keq. “Nuk pajtohem me Kryetarin, sepse ai nuk e di gjendjen në shëndetësinë e Klinës, sepse ai shërbimet shëndetësore i kryen në Prishtinë, e jo në Klinë”, tha ai.

Filloreta Berisha, tha se për mua gjendja në shëndetësinë e Klinës nuk është e mirë, por le të vazhdojmë me këtë që po thonë “mirë”. Nuk dërgohet pacienti për një shërbim në Pejë apo në Prishtinë”, theksoi dr. Berisha.

Rasim Millaku, edhe një herë e rigriti çështjen e mungesës së mjekut në QMF në Ujëmir. “Lidhur me këto çështje asgjë nuk kemi personale, nëse ndonjëri gënjen qoftë i marruar! Në këtë QMF ma tepër se gjysmën e kohës nuk ka mjek. Për dy javë radhazi nuk ka pasur mjek. Një qendër e mjekësisë familjare, siç është ajo e Ujëmirit ka nevojë për t’u mbuluar me mjekë, sepse nevojat e qytetarëve për shërbime mjekësore janë të mëdha”, shtoi anëtari Millaku.

Fadil Gashi, prapë foli rreth çështjes së shëndetësisë në Komunën e Klinës. Në vazhdim anëtari Gashi theksoi se nëse ka keqpërdorim do të kishte për të qenë mirë që rastet të zbulohen në të gjitha kategoritë dhe të drejtohen në prokurori. Anëtari Gashi po ashtu foli edhe rreth mungesës së higjienës në këtë institucion shëndetësor dhe kërkoi që higjiena të jetë në nivelin e duhur,

sepse aty kemi të bëjmë me njerëz të sëmurë. Gashi shtroi edhe disa çështje të tjera që lidhen me shëndetësinë e Klinës dhe kërkoi që të ngritët niveli i shërbimeve shëndetësore në këtë QKMF dhe në gjitha QMF-të tjera ekzistuese në Komunën e Klinës.


Dr. Ali Ahmetxhekaj, foli rreth interesimeve, përkatësisht sqaroi shumë çështje që shtruan nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Haxhi Ibishi, theksoi se kemi pasur nevojë për një debat të këtillë. “Ky debat është i mirëseardhur dhe tepër i frytshëm dhe i dobishëm, krejt më qëllimin më të mirë se sit ë gjejmë rrugët që shëndetësinë në komunën tonë ta vejme në binarët më të shëndoshë dhe të merituar.

Kryesuesi seancën e konstatoi të mbyllur.

Seanca përfundoi në orën 15.00.

Procesmbajtësi,
Mikel Gojani



Kryesuesi i Kuvendit
Dr. Haxhi Ibishi

